



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 2 paragrafi 2.2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Specialistë i Trashëgimisë Historike
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Njësia:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Lloji i pozitave:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Data e njoftimit:	23.08.2022
Afati për aplikim:	23.09.2022 – 07.10.2022
Numri i referencës:	01-111/01-20909
Kohëzgjatja e emërimit:	E pacaktuar

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e tyre;
- b. Hulumtimi, mbrojtja, konservimi, restaurimi, trajtimi, studimi, inventarizimi dhe katalogimi informatik i objekteve, eksponateve dhe dokumentacionit që gjendet në Muze;
- c. Përcaktimi i vlerave dhe dokumentimin e tyre sipas kriterëve shkencorë;
- d. Regjistrimi dhe përgatitja e pasaportave të çdo objekti, eksponati dhe dokumentacioni ekzistues në bazë të të dhënave të përgatitura;
- e. Regjistrimi dhe inventarizimi i çdo ndryshimi të pronësisë së eksponateve, apo ndonjë objekti tjetër që gjendet në Muze;
- f. Të mbledhë materiale edhe me hulumtim në terren. Hulumtimet në terren duhet të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- g. Merret me pritjen e vizitorëve dhe shpjegimin atyre lidhur historinë dhe ekspozitat në muze, promovon muzeun dhe aktivitetet në muze dhe kujdeset për objektin që të jetë në funksion të plote;
- h. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

- f. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a. Arsimimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare në **Etnologji** me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- b. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku **2 (dy) vite përvojë pune** në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:

- a. Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- b. Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- c. Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- d. Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- e. Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- f. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- g. Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Vendi i punës
1.	Zyrtar për Trashëgimi	6.0	Muzeu i Qytetit

6. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet personalisht në *Zyrën e Pranimi* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- c. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- f. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*).

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

10. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruar pa dëshmi).
- c. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.